

Muhamet Mavraj fton
qytetarët në protestën
e 1 tetorit: Të gjithë bashkë
për çlirimtarët | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

NISMA PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT TË DHOMAVE TË SPECIALIZUARA DËRGOHET NË QEVERI | FAQE 3



Nisma e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë është dërguar për mendim në Qeverinë e Kosovës. Lajmi është dhënë të premten

pas mbledhjes së parë të Kryesisë së Kuvendit të legjislaturës së 11. Kryeparlamentarja Albulena Haxhiu ka thënë se është në komunikim me kryeministrin Kurti që kjo çështje të adresohet dhe të trajtohet me prioritet.

Me pajtimin e grupeve parlamentare është vendosur që të hënën të mbahet një seancë e radhës e Kuvendit, ku në rend dite do të jetë miratimi i një deklarate lidhur me vendimin e 16 shtatorit të Gjykatës Speciale

**ISH-KËSHILLTARI
I TRUMPIT THOTË
SE GJYKATA
SPECIALE DUHET
TË SHPËRBEHET:
MENDOJ SE KJO
GJYKATË ËSHTË
E PALIGJSHME** | F. 4-5




**AMBASADA
AMERIKANE: PRESIM
TË PUNOJMË ME
QEVERINË DHE
KUVENDIN E RI
TË KOSOVËS PËR
T'I ÇUAR PËRPARA
PRIORITETET
E PËRBASHKËTA** | F. 4-5



**DHTIK KËRKON NDRËHYRJE
URGJENTE PËR ZHBLOKIMIN E
PROCEDURAVE TË PRONËS PUBLIKE** | F. 8

SPORT



**KOSOVA E NIË ME FITORE
EDICIONIN NË LIGËN B
TË LIGËS SË KOMBEVE** | F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

IRANI THOTË SE I KA PARAQITUR SHBA-së PLANIN PËR RIHAPJEN E HORMUZIT

TEHERANI, 25 SHTATOR - Ministri i Jashtëm iranian, Abbas Araçchi, tha se Teherani i ka paraqitur Shteteve të Bashkuara një plan për rihapjen e Ngushticës së Hormuzit, i cili përfshin kushtet për të cilat të dyja vendet u pajtuan në një memorandum mirëkuptimi të arritur në qershor. “Ne i kemi paraqitur një plan ShBA-së përmes ndërmjetësve, sipas të cilit, nëse plotësohen disa kushte, Ngushtica e Hormuzit do të hapet në fund të ditës së shtatë dhe bisedimet do të rifillojnë”, u tha Araçchi gazetarëve më 24

shtator gjatë pjesëmarrjes në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në Nju Jork. Ai nuk dha hollësi të tjera. CNN citoi një zyrtar të Shtëpisë së Bardhë që tha se të dyja palët po zhvillojnë “diskutime pozitive dhe konstruktive përmes ndërmjetësve”. Të dyja palët duket se vazhdojnë të jenë shumë larg një marrëveshjeje për t’i dhënë fund luftës së tyre gati shtatëmuajore pavarësisht një raundi të ri të diplomacisë. Palët zhvilluan më 23 shtator bisedimet e para indirekte pas



disa muajsh, por Irani dhe ShBA-ja nuk njoftuan publikisht për ndonjë koncesion. Gjatë fjalimeve në OKB, presidenti amerikan Donald

Trump dhe homologu i tij iranian Masud Pezeshkian shkëmbyen deklaratatë të ashpra. Trumpi kërcënoi në fjalimin e tij në OKB se do ta “asgjësojë”

Iranin nëse nuk arrihet një marrëveshje. Pezeshkiani i tha OKB-së se Irani nuk do të “nënshtrohet” nën presion. Megjithatë, të dy udhëheqësit thanë se mbeten të hapur për negociatat. Uashingtoni dhe Teherani nënshkruan më 17 qershor një memorandum mirëkuptimi 60-ditor, që synonte t’u jepte fund armiqësive dhe ta rihapte Ngushticën. Megjithatë, mosmarrëveshjet rreth asaj se çfarë nënkuptojnë kushtet e marrëveshjes kanë çuar në sulme të reja nga të dyja palët.

TEKSA TRUMPI DHE XI TAKOHEN, RRRITET PRESIONI PËR KONFRONTIMIN ME KINËN PËR MBËSHTETJEN NDAJ IRANIT

UASHINGTON, 25 SHTATOR - Ligjvënësit amerikanë dhe ekspertët e sigurisë kombëtare po i bëjnë presion presidentit Donald Trump që të ndërmarrë masa më të ashpra ndaj entiteteve kineze, të cilat akuzohen se po e ndihmojnë Iranin me inteligjencë satelitore, komponentë armësh dhe të ardhura nga nafta. Thirrjet u shtuan teksa udhëheqësi kinez Xi Jinping vizitoi Shtëpinë e Bardhë më 24 shtator për një takim shumë të rëndësishëm me Trumpin, që u pasua nga një darkë shtetërore madhështore që nënvizoi balancimin e kujdesshëm mes dy ekonomive më të mëdha në botë. Trumpi nuk e përmendi në mënyrë eksplicite Iranin gjatë deklaratave të tij publike me Xinë, pavarësisht prej presionit në rritje nga ligjvënësit, të cilët paralajmëruan se Uashingtoni rrezikon të nxisë bashkëpunim më të thellë mes Pekinit dhe Teheranit nëse nuk vendos kosto. “Këtë verë në të gjitha mediet u raportua se Kina i dha Iranit inteligjencë nga imazhet satelitore dhe se kjo inteligjencë çoi në vdekjen e trupave amerikane”, tha në Senat, Roger Wicker nga Misisipi, kryetari republikan i Komitetit të Senatit për Shërbimet e Armatosura, ditën kur Xi mbërriti në ShBA. “Prandaj, sigurisht do t’i sugjeroja presidentit të përpiqet të marrë një përgjigje për këtë”. Jeanne Shaheen nga Nju-Hampshire, demokratja më e lartë në Komitetin e Senatit për

Marrëdhëniet me Jashtë, dhe 18 senatorë të tjerë demokratë e akuzuan Trumpin se nuk po e mbante Xinë përgjegjës për mbështetjen që pretendohet se kompanitë kineze i japin Iranit. Shtëpia e Bardhë nuk ka bërë me dije nëse Trumpi u konfrontua me Xinë lidhur me këto akuza gjatë bisedimeve të tyre private. Presidenti Trump tha se të dy zhvilluan një “takim të shkëlqyer” më 24 shtator, duke shtuar se ai dhe Xi “kanë bërë përparim të jashtëzakonshëm në çështjet me të cilat përballen dy vendet tona”. Megjithatë, ai dha pak hollësi. Agjencia shtetërore e lajmeve kineze, “Xinhua”, tha se gjatë takimit Xi i bëri thirrje Iranit dhe Shteteve të Bashkuara që t’i zgjidhin problemet e tyre përmes dialogut sa më shpejt të jetë e mundur. Shaheen më herët i kishte bërë thirrje Trumpit të ndërmarrë masa ndaj tri fushave të mbështetjes së pretenduar kineze: imazheve satelitore dhe ndihmës për përcaktimin e objektivave, komponentëve për raketat dhe dronët iranianë dhe blerjeve të naftës iraniane që është nën sanksione. Pekini është blerësi më i rëndësishëm i naftës së Teheranit dhe ka ndikim të konsiderueshëm ekonomik mbi Iranin. Por, Irani përbën vetëm një pjesë të vogël të tregtisë së përgjithshme të Kinës, duke i dhënë Pekinit dukshëm më shumë hapësirë për manovrim sesa Teheranit. Për disa ekspertë amerikanë,



megjithatë, çështja shkon përtej marrëdhënies së Kinës me Iranin dhe ngre pyetje më të gjera se si Uashingtoni reagon ndaj Pekinit kur entitetet kineze akuzohen se mbështesin vende armiqësore ndaj ShBA-së. Mary Kissel, bashkëpunëtore e lartë në Institutin Hudson dhe drejtoreshë ekzekutive e The Kissel Group, tha se Uashingtoni duhet t’i mbajë përgjegjëse entitetet kineze të përfshira në mbështetjen ndaj Iranit. “Një nga gabimet e mëdha të dekadave të fundit ishte gatishmëria e administratave amerikane - të të dyja partive - për të toleruar aktivitetet dashakeqe të Kinës në sferat ekonomike, ushtarake dhe diplomatike”, tha Kissel për Radion Evropa e Lirë. “Nëse duam që Kina ta kufizojë mbështetjen e saj për Republikën Islamike të Iranit - që është një synim i arsyeshëm - atëherë duhet t’i mbajmë

përgjegjëse bankat, kompanitë dhe individët kinezë të mbështetur nga shteti për veprimet e tyre”. Ndryshe, tha ajo, Uashingtoni do ta dërgonte mesazhin se Kina “lejohej të luajë sipas një grupi tjetër rregullash”, me pasoja që shtrihen edhe te partnerët e Pekinit në Moskë, Teheran dhe Phenian. Ky shqetësim është veçanërisht i madh lidhur me akuzat se entitetet kineze i kanë ofruar Iranit imazhet satelitore që mund të jenë përdorur në sulmet ndaj forcave amerikane. Christopher Walker, nënkryetar në Qendrën për Analizën e Politikave Evropiane, tha se raportime të tilla duhet të shihen si pjesë e një sfide më të gjerë strategjike. “Duke pasur parasysh se inteligjenca amerikane ka lidhur imazhet satelitore kineze me sulmet ndaj pjesëtarëve të ushtrisë amerikane në rajonin e Lindjes së Mesme, është e rëndësishme që ShBA-ja të ndërmarrë masa më të ashpra ndaj Pekinit, i cili do të kërkojë çdo mundësi për të shfrytëzuar dobësitë e ShBA-së”, tha Walker për Radion Evropa e Lirë. Ai e përshkroi mbështetjen kineze për Iranin si pjesë të përpjekjes më të gjerë të Pekinit për t’i ndihmuar qeveritë me të cilat ka interesa të përbashkëta, duke formuar atë që ai e quajti një “bosht autokracish” që është i rrezikshëm. Megjithatë, pretendimi për imazhet satelitore mbetet i

kontestuar. “The Wall Street Journal”, duke cituar zyrtarë amerikanë, raportoi se entitete kineze i kishin ofruar Iranit imazhe me rezolucion të lartë të një baze amerikane në Jordani para një sulmi iranian që vrau tre ushtarë amerikanë dhe plagosi katër të tjerë. Pekini ka mohuar se i ka ofruar Iranit mbështetje ushtarake ose të inteligjencës. Gawdat Bahgat, profesor i çështjeve të sigurisë kombëtare në Qendrën për Studime Strategjike për Lindjen e Afërt dhe Azinë Jugore të Universitetit Kombëtar të Mbrojtjes, bëri thirrje për kujdes që këto akuza të mos trajtohen si fakte të mirëqena. “Si Kina ashtu edhe Irani nuk e kanë konfirmuar ndarjen e imazheve satelitore [ose] të komponentëve të armëve”, tha Bahgat për Radion Evropa e Lirë. Në të njëjtën kohë, Bahgat tha se Pekini ka një interesim të qartë ekonomik për ruajtjen e marrëdhënieve me Teheranin, veçanërisht përmes blerjes së naftës iraniane me çmim të lirë. “Dyshoj se Kina do ta ndalojë blerjen e naftës iraniane”, tha ai. Duke cituar Departamentin Amerikan të Thesarit, Shaheen tha se 90 për qind e eksporteve të naftës së Iranit shkojnë në Kinë, duke gjeneruar miliarda dollarë për Teheranin pavarësisht prej sanksioneve amerikane. Ajo tha se një pjesë e madhe e kësaj tregtie zhvillohet përmes flotave në hije, kompanive fiktive dhe rafinerive kineze.

MALI I ZI VENDOS VIZA PËR SHTETASIT NGA RUSIA, BJELLORUSIA DHE TURQIA

PODGORICË, 25 SHTATOR - Qeveria e Malit të Zi miratoi Informacionin për nevojën e anulimit të marrëveshjeve me të cilat rregullohet regjimi pa viza me Federatën Ruse, Bjellorusinë dhe Turqinë.

Siç thuhet në njoftim, do të inicohet edhe lidhja e një marrëveshjeje të re me Turqinë për mbajtësit e pasaportave diplomatike, zyrtare dhe speciale. Mali i Zi, në kuadër të procesit të

anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE), është i detyruar ta harmonizojë plotësisht politikën e tij të vizave me politikën e vizave të BE-së. Qeveria e Malit të Zi më 23 korrik të këtij viti miratoi ndryshimet

në Rregulloren për regjimin e vizave, me të cilat përcaktohet se, nga 1 nëntori, shtetasve të vendeve të përmendura do t’u nevojitet vizë për hyrje, kalim nëpër territor dhe qëndrim në Mal të Zi.



NISMA PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT TË DHOMAVE TË SPECIALIZUARA DËRGOHET NË QEVERI

Nisma e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë është dërguar për mendim në Qeverinë e Kosovës. Lajmi është dhënë të premten pas mbledhjes së parë të Kryesisë së Kuvendit të legjislaturës së 11. Kryeparlamentarja Albulena Haxhiu ka thënë se është në komunikim me kryeministrin Kurti që kjo çështje të adresohet dhe të trajtohet me prioritet. Me pajtimin e grupeve parlamentare është vendosur që të hënë të mbahet një seancë e radhës e Kuvendit, ku në rend dite do të jetë miratimi i një deklarate lidhur me vendimin e 16 shtatorit të Gjykatës Speciale

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Arian Tahiri nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) tha se nisma e partisë së tij për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë është dërguar për mendim në Qeverinë e Kosovës. “[Kryetarja e Kuvendit, Albulena] Haxhiu u zotua se personalisht ajo do të angazhohet dhe do të komunikojë me Kurtin që të trajtohet me urgjencën e nevojshme”, tha ai të premten pas mbledhjes së parë të Kryesisë së Kuvendit të legjislaturës së 11. Sipas tij, Haxhiu është zotuar se do të flasë me kryeministrin Albin Kurti, duke shtuar se me procedura të përshpejtuara projektligji mund të hidhet në

votim të hënë apo të martën e javës tjetër. “Në rrethanat që janë dhe jemi kërkohet përgjegjësi kombëtare, politike dhe karshi kësaj, ne jemi duke thirrur për unitet kombëtar dhe politik”, tha Tahiri, duke shtuar se PDK-ja vlerëson se hapi urgjent i Kuvendit është votimi i ndryshimeve të propozuara në Ligjin për Dhomat e Specializuara.

Tahiri tha, po ashtu, se gjatë seancës të së hënës, Kuvendi, po ashtu, do të dalë me deklaratë të përbashkët lidhur me vendimin e 16 shtatorit, kur katër ish-eprorët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) u shpallën fajtorë për krime lufte. “Isha këtu në emër të PDK-së me qëllimin e vetëm për të kërkuar që Kuvendi i Republikës së Kosovës të sillet me përgjegjshmëri, të reflektojë

ndërgjegje, gatishmëri dhe t'i bëjë veprimet e nevojshme, të duhura dhe urgjente karshi situatës me të cilën po ballafaqohet vendi ynë”, tha Tahiri, duke shtuar se UÇK-ja është e të gjithëve dhe të gjithë bashkërisht e kanë obligim moral dhe kombëtar ta mbrojnë UÇK-në dhe çlirimtarët.

Edhe kryeparlamentarja Albulena Haxhiu ka folur pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, ku është vendosur që të hënë të mbahet seanca e radhës e Kuvendit, në rend dite të së cilës do të jetë edhe miratimi i një deklarate lidhur me Gjykatën Speciale. Ajo ka treguar se Ligjin për Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë

e ka pranuar dhe e ka proceduar në qeveri. “Me ligj, qeveria ka 30 ditë në dispozicion. Nëse nuk i shfrytëzon, ligji procedohet pa mendimin e qeverisë. Kam komunikuar me Kurtin, fola edhe sot. Do ta adresoj që të trajtohet me prioritet, sidomos kur i kemi ditët e numëruara”, ka thënë ajo, duke shtuar se njëherë nuk mund të flasë për përmbajtjen e këtij ligji. “S’mund të flas për përmbajtjen. E kam proceduar te grupet për analizë dhe do të flasim”, ka treguar Haxhiu. Kryeparlamentarja Albulena Haxhiu ka thënë se do të ishte mirë që PDK-ja t'i konsultojë ta gjithë partitë për ta draftuar ndryshimin e këtij ligji. Ajo ka theksuar se, sipas informac-

ioneve që ka, nuk janë konsultuar edhe ekipet mbrojtëse, duke thënë se një gjë e tillë është gabim.

Haxhiu ka thënë se pas një mbledhjeje të gjatë dhe aspak të lehtë që kishin me kryetarët e grupeve parlamentare apo përfaqësuesit e tyre, pesë grupe parlamentare janë formuar dhe kanë dorëzuar përbërjen e tyre. “Kryesia e Kuvendit ka vendosur që seanca e radhës e Kuvendit të mbahet të hënë, ku do të ketë pika të rëndësishme të rendit të ditës. Do të betohen deputetët, pastaj do të jetë edhe miratimi i një deklarate që lidhet me procesin në Hagë, përkatësisht me vendimin e padrejtë të Gjykatës Speciale. Jemi marrë vesh në Kryesi të Kuvendit që deputetët të mos vendosen paraprakisht para një akti të kryer, mirëpo të kontribuojnë në draftimin e kësaj deklarate. Pra, që të jetë një qëndrim i Kuvendit lidhur me situatën aktuale. Ju e dini se deklaratat nuk kanë ndonjë peshë juridike, por politikisht Kuvendi ta ketë një qëndrim në raport me këtë proces”, tha Haxhiu pra medieive. Deputeti i Aleancës, Besnik Tahiri, ka konfirmuar se nisma ligjore e PDK-së për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dhomat e Specializuara tashmë është në qeveri dhe kjo parti do ta përkrahë.

MUHAMET MAVRAJ FTON QYTETARËT NË PROTESTËN E 1 TETORIT: TË GJITHË BASHKË PËR ÇLIRIMTARËT



PRISHTINË, 25 SHTATOR - Një nga ish-udhëheqësit dhe një nga figurat e protestave të 1 tetorit 1997, Muhamet Mavraj, u ka bërë thirrje qytetarëve t'i bashkohen protestës së paralajmëruar për çlirimtarët më 1 tetor 2026 në sheshin “Skënderbeu” në Prishtinë. Në një videomesazh, Mavraj e ka cilësuar 1 tetorin e vitit 1997 një prej çasteve më të rëndësishme të mobilizimit

qytetar të shqiptarëve para luftës në Kosovë. Ai ka kujtuar pjesëmarrjen në protestën e asaj kohe, duke përmendur edhe personat që, sipas tij, nuk janë më në mesin e të gjallëve.

“1 tetori i '97-s është dita më e madhe e unitetit të shqiptarëve para luftës. Isha atë ditë bashkë me ju dhe shumë të tjerë. Shumë prej tyre sot janë dëshmorë”, ka

thënë Mavraj. Duke iu referuar protestës së 1 tetorit 2026, ai i ka ftuar qytetarët të mblidhen në sheshin “Skënderbeu” nga ora 16:00 në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së. “Me këtë 1 tetor, në orën 16:00, në sheshin tonë, për bacën Pejtër, për Calin, për Bacën Jakup, Kadriun, Rexhën dhe kryestrategun e lirisë, Hashim Thaçin. Të gjithë bashkë: Jo në

emrin tonë”, është shprehur ai. Edhe kryetari i PDK-së, Bedri Hamza, ka ftuar qytetarët që më 1 tetor t'i bashkohen protestës në sheshin “Skënderbeu” në Prishtinë. Përmes një deklarate, Hamza ka bërë me dije se protesta do të nisë në orën 16:00 dhe se në të pritët të marrin pjesë studentët, veteranë dhe qytetarë. “Ju ftoj që më 1 tetor,

në orën 16:00, në sheshin ‘Skënderbeu’ në Prishtinë, të bashkohemi me studentët, veteranët dhe qytetarët e vendit tonë për ta ngritur zërin kundër padrejtësisë në Hagë”, ka deklaruar Hamza. Ai ka bërë thirrje për bashkim në mbrojtje të asaj që e cilëson të drejtë dhe dinjitet. “Të gjithë bashkë, më 1 tetor! Të gjithë bashkë kundër padrejtësisë!”, ka thënë Hamza.



ÇFARË STRATEGJIE MUND TA NDJEKË QEVERIA E KOSOVËS PËR APELIN NË HAGË?

Tetë ditë pasi katër ish-krerë të UÇK-së u shpallën fajtorë për krime lufte nga Gjykata Speciale, në Kosovë po shtohen thirrjet për një strategji shtetërore për apelin. Qeveria e Albin Kurtit ka paralajmëruar hartimin e saj, por ende nuk ka shpjeguar se çfarë do të përfshijë. Çfarë roli mund të ketë Ministria e Drejtësisë, çfarë ekspertize dhe dokumentesh mund të mobilizohen, dhe si mund të angazhohet diplomacia, pa ndërhyrë në përgjegjësinë e ekipeve të mbrojtjes?

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Tetë ditë nga dënimi me burgim të përgjithshëm prej 81 vjetësh i katër ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) nga Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë, protestat kundër vendimit të shkallës së parë dhe thirrjet për një strategji shtetërore në apelin e tij po vazhdojnë të rriten. Kjo strategji, të cilën Qeveria e Kosovës është zotuar se do ta hartojë, nuk duhet të kufizohet thjesht në financimin e ekipeve të mbrojtjes, por duhet të përfshijë grumbullimin e ekspertizës vendëse dhe ndërkombëtare, si dhe një angazhim të bashkërenduar diplomatik, vlerësojnë njohës të zhvillimeve politike, me të cilët bisedoi Radio Evropa e Lirë (REL).

Një strategji shtetërore përtej apelit

Qeveria e Albin Kurtit nuk ka shpjeguar se si do të dukej strategjia për ta luftuar në Apelin e asaj që njihet si Gjykata Speciale aktgjykimin dënues për krime lufte ndaj Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit. Zyra e Kurtit nuk i është

përgjigjur pyetjeve të REL-it për më shumë hollësi rreth saj. Por, duke folur për strategjinë më 19 shtator, Kurti kishte thënë se nevojitet pajtueshmëri për reagim sa më të përshtatshëm dhe efikas ndaj verdiktit, si në ndihmën e ekipeve në instancat e apelit, ashtu edhe në rrafshin diplomatik. Për Donika Eminin nga Grupi Këshillues për Politikën e Ballkanit në Evropë dhe ish-deputetin e Kuvendit të Kosovës, Ilir Deda, në strategji duhet të përfshihen të gjitha institucionet e vendit, si dhe opozita, ndërsa atë duhet ta shtyjë përpara Ministria e Drejtësisë. Ky dikaster qeveritar nuk është deklaruar deri tani rreth aktgjykimit, e aq më pak rreth ndonjë strategjie. Udhëheqësja e tij, Donika Gërvalla, është në qendër të kritikave, ndërsa shkarkimi i saj është ndër kërkesat e vazhdueshme në protestat e përnatshme në sheshet e kryeqytetit të Kosovës.

Ekspertizë vendëse dhe ndërkombëtare

Përtej rolit të Ministrisë së Drejtësisë, Emini dhe Deda sugjerojnë se strategjisë do t'i duhej një mekanizëm i qartë

koordinues mes institucioneve, ekipeve të mbrojtjes, ekspertëve dhe përfaqësuesve të Kosovës jashtë vendit. Kjo, sipas tyre, do t'i shmange veprimet e ndara, dhe do të përcaktonte se kush mbledh dokumentet, kush bashkërendon ekspertizën dhe kush është përgjegjës për komunikimin diplomatik. Deda këshillon që Kosova të grumbullojë ekspertë të fushave të ndryshme, si juristë ndërkombëtarë, historianë, arkivistë, ekspertë ushtarakë dhe hulumtues të dokumenteve, për t'i ndihmuar mbrojtjes së secilit prej të dënuarve të arrijnë sukses në apel. “Roli i tyre nuk është ta rishkruajnë historinë apo të krijojnë fakte të reja, por të ndihmojnë mbrojtjen të gjejë dhe ta kuptojë materialin ekzistues”, sipas Dedës. Ai thotë se prioritet duhet të jenë juristët me përvojë të drejtpërdrejtë në procedurat e apelit para gjykatave penale ndërkombëtare. “Apeli nuk është përsëritje e gjykimit. Ai duhet të identifikojë saktësisht gabimet juridike që e bëjnë aktgjykimin të paqëndrueshëm, gabimet faktike që kanë shkaktuar padrejtësi, si dhe gabimet në përcaktimin e dënimit”, nënvizon Deda.

Kjo, sipas tij, nënkupton se mbështetja shtetërore duhet të përshtatet me nevojat e ekipeve të mbrojtjes, dhe me standardet procedurale të apelit, ndërsa vendimmarrja për argumentet dhe strategjinë juridike mbetet te mbrojtja. Emini, në anën tjetër, argumenton se, përveç mbështetjes së drejtpërdrejtë të ekipeve të mbrojtjes, ekspertiza ndërkombëtare mund të jetë veçanërisht e rëndësishme për një dimension tjetër: për diplomacinë, për komunikimin ndërkombëtar. “Për ta vendosur rastin në një kontekst më të gjerë dhe për të pasur diskutime mbi vetë mënyrën se si është trajtuar ky proces, pa e reduktuar çdo diskutim në tensionet politike që ekzistojnë brenda Kosovës”, thotë ajo.

Viktimat dhe diplomacia

Trupi gjyqës në Hagë e shpalli katërshtetërore dhe shpallë krimet e luftës si ndalimi arbitrar, trajtimi mizor dhe torturimi i qindra njerëzve, dhe për vrasjen e 96 njerëzve. Deda thekson se derisa Kosova duhet përmes diplomacisë ta bëjë të qartë se aktgjykimi i shkallës së parë nuk është përfundimtar dhe se

përgjegjësia penale e individëve nuk mund të shndërrohet në faj kolektiv të UÇK-së, të luftës çlirimtare apo të vetë shtetit të Kosovës, mbështetja e apelit nuk duhet të shndërrohet në mohim të vuajtjes së viktimave. “Respekti për viktimat nuk e dobëson mbrojtjen; përkundrazi, ia shton kredibilitetin”, thotë Deda. Teksa thotë se diplomacia duhet të jetë pjesë e secilësdo strategjie të ardhshme në procesin e apelit, Emini thekson se qeveria duhet të jetë shumë më e kujdesshme dhe më strategjike në mënyrën se si e bën këtë. “Diplomacia nuk është thjesht të shkosh në çdo takim dhe të thuash se nuk pajtohesh me aktgjykimin dhe se gjykata ka gabuar”, thotë ajo. Emini kritikon qeverinë për mungesë veprimi në këtë fushë, duke thënë se do të duhej të kishte investuar më shumë në krijimin e një diskutimi ndërkombëtar rreth këtij procesi, që nisi me arrestimin e katërshtetërore më 2020. Qëllimi, sipas saj, nuk do të ishte të bëhej trysni e drejtpërdrejtë mbi gjykatën, por që procesi të ndiqej, të studiohej dhe të diskutohej në mënyrë serioze në qarqet juridike, akademike dhe politike.

AMBASADA AMERIKANE: PRESIM TË PUNOJMË ME QEVERINË DHE KUVENDIN E RI TË KOSOVËS PËR T'I ÇUAR PËRPARA PRIORITETET E PËRBASHKËTA

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Ambasada Amerikane në Prishtinë tha se mezi pret që të punojë me Qeverinë dhe Kuvendin e ri të Kosovës për t'i "avancuar prioritetet e përbashkëta, përfshirë paqen rajonale, stabilitetin dhe prosperitetin e ndërsjellë". Ky njoftim i Ambasadës, i publikuar në rrjetet sociale, vjen dy ditë pasi Gjykata Kushtetuese tha se Qeveria e re e Kosovës, e udhëhequr nga Albin Kurti, është zgjedhur në mënyrë kushtetuese. "Ambasada e ShBA-së pret me kënaqësi të

bashkëpunojë me Qeverinë dhe Kuvendin për t'i çuar përpara prioritetet e përbashkëta, përfshirë paqen rajonale, stabilitetin dhe prosperitetin e ndërsjellë", thuhet në njoftimin e saj. Gjykata më e lartë në vend qartësoi se deputetët e legjislaturës së njëmbëdhjetë kanë afat deri më 6 tetor ta zgjedhin presidentin e ri të vendit. Sa i përket konstituimit të Kuvendit, Kushtetuesja u kërkoi deputetëve ta zgjedhin edhe nënkryetarin e dytë nga radhët e

Partisë Demokratike të Kosovës. Megjithatë, Gjykata konstatoi se organi ligjvënës u konstituua përtej afatit 30-ditor. Kuvendi u konstituua më 13 shtator dhe disa orë më vonë u votua edhe Qeveria Kurti 4. Megjithatë, njoftimi i Kushtetueses ka vënë në lëvizje Kuvendin, kryesia e të cilit mban sot mbledhjen e parë të legjislaturës së njëmbëdhjetë. Në dy vitet e fundit Kosova është përballur me kriza të vazhdueshme politike. Në qershor, vendi mbajti zgjedhje të parakohshme parlamentare pasi

partitë politike nuk arritën konsensus rreth zgjedhjes së presidentit. Pas zgjedhjeve të qershorit, Lëvizja Vetëvendosje, fituese e zgjedhjeve dhe Lidhja Demokratike e Kosovës, që doli fuqia e tretë politike, arritën një marrëveshje për presidentin në fund të gushtit, duke propozuar si kandidat konsensual ish-gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese dhe ish-diplomatin Bekim Sejdiu. Megjithatë, vetëm një ditë më pas, më 1 shtator, u bë e qartë se gjashtë deputetë të LDK-së ishin

kundër këtij emri, duke bërë që në praktikë Sejdiu të mos kishte 81 vota apo dy të tretat e Kuvendit me 120 ulëse që kërkohen për procesin e zgjedhjes së presidentit. Më 14 shtator Sejdiu njoftoi për tërheqje nga kandidatura duke përmendur si arsye mungesën e mbështetjes së deputetëve. Nëse deputetët nuk arrijnë të gjejnë pajtim për presidentin, vendi rrezikon të shkojë drejt zgjedhjeve të reja. Ato do të ishin votimet e katërta që nga shkurti i vitit 2025 dhe të dytat për shkak të moszgjedhjes së presidentit.



ISH-KËSHILLTARI I TRUMPIT THOTË SE GJYKATA SPECIALE DUHET TË SHPËRBEHET: MENDOJ SE KJO GJYKATË ËSHTË E PALIGJSHME

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Ish-këshilltari për Sigurinë Kombëtare i presidentit Donald Trump, John Bolton, ka kërkuar shpërbërjen e Gjykatës Speciale. Ai ka vlerësuar se kjo gjykatë është e paligjshme. Në një intervistë në A2CNN, Bolton ka bërë me dije se kjo gjykatë është karakterizuar me element të rëndë politik. "Ka qenë një kohë e gjatë që prej shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, dhe të mendosh në një pikë që mund ta quash këtë një fund,

sinqerisht s'jam i sigurt që vendet që e kanë krijuar këtë gjykatë... Nëse dikush është i pakënaqur, nëse Kosova është e pakënaqur, duhet të flasin dhe ta thonë që kemi arritur kufijtë e tolerimit. I ka tejkaluar kufijtë e asaj që mendonim dhe kishim rënë dakord", ka thënë ai, duke vazhduar kundërshtimin e tij ndaj llojit të tillë të gjykatave. "Dikush duhet ta kuptojë që këto trupa gjyquese kur u krijuan nuk ishin kaq virtuoze sepse ishin ndërkombëtare, dhe

që mungesa e mbikëqyrjes mund të çojë drejt rrethanave ku ato humbasin rrugët dhe shkojnë në drejtime që askush s'i kishte menduar dhe shkaktojnë dëme. Duke u fokusuar në mendjengushtësi, për akuzat e gabimeve gjatë luftës, siç e bënë, japin mundësinë për mospajtim dhe heqin dorën nga çfarë do lloj përgjegjësie dhe forme papërgjegjshmërie që liderët kanë bërë në të kaluarën", është shprehur ai.



Prattipati takoi kryeprokurorin Isufaj, diskutojnë për vazhdimin e bashkëpunimit

PRISHTINË, 25 SHTATOR - E ngarkuara me punë e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Kosovë, Anu Prattipati, ka zhvilluar takim me kryeprokurorin e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), Blerim Isufaj. Sipas njoftimit

të Ambasadës Amerikane, takimi u zhvillua për të diskutuar vazhdimin e bashkëpunimit të suksesshëm me PSRK-në. Në takim është diskutuar edhe luftimi i kërcënimeve ndaj sigurisë kombëtare të ShBA-së, përfshirë terrorizmin,

trafikimin e drogës dhe migrantëve, krimet kibernetike si dhe organizatat kriminale transnacionale. Ambasada Amerikane ka theksuar rëndësinë e vazhdimin të bashkëpunimit me institucionet e Kosovës në këto fusha.



‘NE NUK HARROJMË!’ - ZËRI I KUJTESËS, I DHIMBJES DHE I QËNDRESËS



Lulëzim ETEMAJ

Më 26 shtator 2026, në orën 18:00, Qendra “Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur” organizon përrurimin e këngës “NE NUK HARROJMË!”, kushtuar viktimave të gjenocidit të kryer nga Serbia ndaj shqiptarëve gjatë luftës në Kosovë. Kënga, e kompozuar nga Edmond Zhulali, me tekst të Fran Laskës, interpretohet nga Enkelejda Arifi, Ilir Shaqiri, Kastriot Tusha, Nikollë Nikprelaj dhe Selami Kolonja.



Shteti i Serbisë ka kryer krime dhe gjenocid në Kosovë, e jo Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Kjo duhet të thuhet zëshëm, qartë dhe pa hezitim edhe në të gjitha protestat që po mbahen këto ditë, si në Prishtinë dhe në qytetet e tjera të Kosovës, ashtu

edhe jashtë vendit, kundër dënimeve politike të Gjykatës Speciale të Hagës ndaj çlirimtarëve Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli, Salih Mustafa dhe Pjetër Shala. Kënga “NE NUK HARROJMË!” do ta bëjë të kumbojë edhe më

fuqishëm zërin tonë protestues. Ajo nuk është vetëm një këngë; është një thirrje për kujtesë, një dëshmi e dhimbjes dhe një zë i qëndresës. Prandaj, do të duhej të bëhej pjesë e pashmangshme e këtyre protestave dhe e çdo përpjekjeje për të mbrojtur të vërtetën historike. Nga 26 shtatori e tutje, le të jehojë “Ne nuk harrojmë” në çdo protestë “Jo në emrin tim!” që do të mbahet. Le të bëhet kjo këngë një zë i përbashkët i kujtesës dhe i dhimbjes sonë, një jehonë që bashkon njerëzit rreth kërkesës që e vërteta të mos harrohet dhe sakrifica e viktimave të mos zbehet kurrë. Kënga mbart një mesazh të fuqishëm kushtuar kujtesës historike dhe ruajtjes së dëshmimeve të gjenocidit e të sakrificës së popullit tonë për lirinë e Kosovës. Ajo synon njëkohësisht sensibilizimin e opinionit kombëtar dhe

ndërkombëtar, që tragjeditë e së kaluarës të mos harrohen, që dëshmitë të ruhen dhe që drejtësia për viktimat të kërkohej me këmbëngulje. Sepse kujtesa nuk shuhet. Dhimbja nuk harrohet. Dhe zëri i një populli që ka përjetuar tragjedi nuk mund të heshtë. Siç thonë edhe vargjet e këngës: “Lidhur prangash ne kënduam Mbi k’të dhë të përgjakur, Se shqiptari ngrihet prapë Si Ante në qiell t’përflakur” Këto vargje janë edhe një kujtesë se, përballë dhimbjes, humbjes dhe padrejtësisë, qëndron vullneti për t’u përballur me goditjet, për të mos harruar dhe për të dëshmuar atë që ka ndodhur. Le të dëgjohej zëri i viktimave. Le të ruhet kujtesa dhe të nderohen e të mbrohen sakrifica jonë dhe çlirimtarët. Le të mos shtrembërohet historia dhe të mos harrohet e vërteta.

OIK DHE QKMF-TË FORCOJNË BASHKËPUNIMIN PËR KUJDES SHËNDETËSOR MË TË QASSHËM DHE CILËSOR

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Oda e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë shëndetësorë të Kosovës (OIK) dhe Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) nënshkruan Memorandum të Mirëkuptimit, me fasilitimin e Projektit “Kujdesi shëndetësor i qasshëm dhe cilësor”. Memorandumi synon forcimin e bashkëpunimit institucional dhe profesional ndërmjet OIK-ut dhe QKMF-ve, me fokus në avancimin e shërbimeve të kujdesit parësor shëndetësor dhe në krijimin e mundësive për zhvillim të mëtejshëm profesional të infermierëve. Në ceremoninë e nënshkrimit, kryetarja e OIK, Nexhmije Gori,

tha se ky memorandum përfaqëson më shumë sesa një dokument bashkëpunimi, duke e cilësuar atë hap konkret drejt një bashkëpunimi më të strukturuar në funksion të qytetarëve. “Mjekësia familjare është pika e parë e kontaktit të qytetarëve me sistemin shëndetësor, ndërsa infermierët janë një pjesë e pandashme e këtij shërbimi”, tha Gori, duke theksuar rolin e infermierëve në komunitet, familje dhe institucionet e kujdesit shëndetësor. Ajo vlerësoi se forcimi i rolit të infermierëve, mbështetja profesionale dhe mundësitë për zhvillim të vazhdueshëm përbëjnë investim të



drejtëpërdrejtë në cilësinë e shërbimeve shëndetësore. Sipas OIK-ut, memorandum i krijon

mundësi për ndërtimin e urave më të forta të bashkëpunimit me QKMF-të, shkëmbimin e

përvojave profesionale dhe kontributin në zhvillimin e mëtejshëm të praktikës infermiore në kujdesin parësor. Kryetarja e OIK-ut falënderoi fascilituesit e projektit “Kujdesi shëndetësor i qasshëm dhe cilësor” për mbështetjen e këtij bashkëpunimi, duke shprehur besimin se memorandum i do të konkretizohet përmes aktiviteteve dhe rezultateve të prekshme për profesionistët shëndetësorë dhe qytetarët. Ceremonia mbledhi përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë, drejtues të institucioneve shëndetësore, drejtues të QKMF-ve, përfaqësues të projektit dhe profesionistë shëndetësorë.

Haxhiu pret ambasadorin e Danimarkës, flasin për thellimin e bashkëpunimit



PRISHTINË, 25 SHTATOR - U. d. presidentja e Republikës së Kosovës, Albulena Haxhiu, priti të premten në takim ambasadorin jorezident të Mbretërisë së Danimarkës në Kosovë, Christian Grønbech-Jensen. Gjatë takimit u diskutua për

marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Danimarkës, zhvillimet aktuale në vend si dhe për mundësitë e thellimit të bashkëpunimit në fusha me interes të përbashkët. U. d. presidentja Haxhiu shprehu mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme të

Danimarkës ndaj Kosovës dhe për kontributin e saj ndër vite në paqe, siguri dhe zhvillim. U. d. presidentja dhe ambasadori Grønbech-Jensen rikonfirmuan gatishmërinë për vazhdimin dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve.

IKD: DËNIMI ME KUSHT NUK DUHET TË MBETET 'KUSHT PA KUSHTE'

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka publikuar raportin "(Mos)kushtëzimi i dënimit me kusht", i cili trajton zbatimin e dënimit me kusht në praktikën gjyqësore në Kosovë, me fokus të veçantë te detyrimet specifike që mund t'i caktohen të dënuarit gjatë periudhës së verifikimit.

Anesa Hoxha nga IKD theksoi se dënimi me kusht nuk duhet të kuptohet vetëm si pezullim i ekzekutimit të dënimit me burgim, por si mekanizëm që duhet t'i shërbejë rehabilitimit të kryesit, parandalimit të veprave të reja penale dhe, kur është e mundur, adresimit të pasojave ndaj viktimës. Sipas saj, detyrimet specifike i japin përmbajtje dënimit me kusht dhe e bëjnë atë më të matshëm, më të kontrollueshëm dhe më të lidhur me rrethanat konkrete të rastit. Hoxha theksoi se raporti nuk synon ta kontestojë rëndësinë e dënimit me kusht si dënim alternativ, por të tregojë se ky dënim mund të jetë më efektiv kur shqiptohet pas një vlerësimi të mirëfilltë dhe kur, aty ku është e nevojshme,

shoqërohet me detyrime të qarta, të arsyetuara dhe të zbatueshme.

Gjetjet kryesore të raportit u paraqitën nga Gzim Shala nga IKD. Ai theksoi se IKD ka analizuar 300 aktgjykime të viteve 2023, 2024 dhe 2025, në të cilat janë identifikuar gjithsej 320 dënime me kusht. Sipas tij, gjetja kryesore është se detyrimet specifike përdoren shumë rrallë në praktikën gjyqësore.

Nga 320 dënime me kusht, gjykatat kanë shqiptuar vetëm 17 detyrime specifike, ndërsa vetëm 12 nga 300 aktgjykimet e analizuar kanë përmbajtur ndonjë detyrim. Edhe pse Kodi Penal parasheh 15 lloje të detyrimeve, në rastet e analizuar janë përdorur vetëm gjashtë prej tyre, kryesisht kompensimi i viktimës, ndalimi i përdorimit të alkoolit apo drogës dhe trajtimi mjekësor ose rehabilitues.

Shala theksoi se një ndër problemet kryesore mbetet mungesa e arsytimit. Në 288 aktgjykime ku është shqiptuar dënim me kusht pa ndonjë detyrim specifik, gjykatat nuk kanë shpjeguar pse në rastin konkret nuk ka qenë i



nevojshëm ndonjë detyrim. Sipas IKD-së, kjo pamundëson të kuptohet nëse gjykata e ka shqyrtuar fare mundësinë e shqiptimit të detyrimeve specifike.

Raporti trajton edhe rolin e shërbimit sprovues. Në 23 raste është urdhëruar mbikëqyrja nga ky shërbim, por në 18 prej tyre nuk është përcaktuar ndonjë detyrim

konkret që duhet të mbikëqyret. Sipas IKD-së, kjo krijon paqartësi mbi përmbajtjen reale të mbikëqyrjes dhe rrezikon që ajo të mbetet vetëm formale.

Një gjetje tjetër lidhet me recidivizmin. Në gjysmën e aktgjykimeve të analizuar gjykatat nuk kanë evidentuar nëse personi ka qenë apo jo i dënuar më parë. Ndërkaq, në 28 raste ku vetë aktgjykimi evidentonte se personi kishte të kaluar penale, gjykata sërish ka shqiptuar dënim me kusht, në disa raste edhe kur bëhej fjalë për përsëritje të së njëjtës apo të një vepre të ngjashme penale.

IKD rekomandon që gjykatat të japin arsyetime më të plota lidhur me shqiptimin e dënimit me kusht dhe mosshqiptimin e detyrimeve specifike, prokurorët të jenë më aktivë në propozimin e këtyre detyrimeve, Shërbimi Sprovues të përfshihet në mënyrë më të qartë, ndërsa kjo çështje të trajtohet më shumë përmes trajnimeve dhe udhëzimeve praktike. Sipas IKD-së, dënimi me kusht duhet të jetë alternativë reale ndaj burgimit: jo "kusht pa kushte", por dënim që rehabiliton, mbron viktimën dhe parandalon përsëritjen e veprës penale.

KURTI: RADOIÇIQI DUHET TË PËRBALLET ME DREJTËSINË NË KOSOVË PËR SULMIN NË BANJSKË

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se vendi nuk do të ndalet derisa përgjegjësit për sulmin në Banjskë të Zveçanit, në krye me Millan Radoiçiqin, të përballen me drejtësinë në Kosovë.

Në një ngjarje përkujtimore në trevjetorin e sulmit në Banjskë, kur një grup i serbëve të armatosur sulmuan Policinë e Kosovës, duke vrarë rreshterin Afrim Bunjakun, Kurti tha se Serbia po e mbron Radoiçiqin. "Tre vjet nga sulmi i Banjskës, Millan Radoiçiq dhe pjesëtarët e tjerë të grupit terrorist paramilitar, vazhdojnë të strehohen nga presidenti i Serbisë, teksa i ofron mbrojtje dhe shërbime. Ata duhet të përballen me drejtësinë në Kosovë dhe të gjykojnë për sulmin me përmasa ushtarake, të organizuar ndaj shtetit tonë, dhe vrasjes e Afrim Bunjakut. Ne nuk do të ndalemi derisa të ketë drejtësi të plotë", tha Kurti. Radoiçiq, ish-nënkryetar i Listës



Serbe - partisë kryesore të serbëve në Kosovë që gëzon mbështetjen e Beogradit zyrtar - ka marrë përgjegjësinë për sulmin.

Kosova vazhdimisht kërkon ekstradimin e tij nga Serbia, ku ka adresë të regjistruar banimi.

Kurti kujtoi Bunjakun, duke thënë se ai u vra duke mbrojtur shtetin dhe paqen. "Falë sakrificës dhe aktit heroik të Afrim Bunjakut, nuk u ndal rruga e drejtë e shtrirjes së sovranitetit në 17 për qind të territorit të vendit tonë", tha Kurti.

Kurti tha se sulmi i armatosur në Banjskë ishte tentim për të imituar një metodë hibride të Rusisë: "aneksimin e territorit", duke e akuzuar Serbinë se ka mbështetur, ka financuar dhe ka trajnuar grupin që kreu sulmin. Ndërkaq, ushtruesja e detyrës së presidentit, Albulena Haxhiu, tha se përpjekjet për "shkëputje dhe aneksim" të veriut të Kosovës - të banuar me shumicë serbe - dështuan falë "guximit, profesionalizmit dhe vendosmërisë së Policisë së Kosovës".

Ministri i Brendshëm, Xhelal Sveçla, tha se me sulmin në Banjskë, Serbia tentoi "aneksimin e 17 për qind" të territorit të Kosovës.

Kosova ka akuzuar Serbinë për sulmin që e cilëson terrorist, por Beogradi ka mohuar çdo përfshije.

Në përvjetorin e tretë të sulmit në Banjskë, Bashkimi Evropian kritikoi Serbinë, duke thënë se ende nuk ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për të "arrestuar dhe

ndjekur penalisht ata, me akuzë përkatëse, të personave që gjenden në Serbi".

Thirrje që përgjegjësit për sulmin të përballen me drejtësinë bëri edhe aleanca ushtarake perëndimore e NATO-s. "Ne vazhdojmë të bëjmë thirrje që përgjegjësit të dalin para drejtësisë. Serbia është e rëndësishme për stabilitetin rajonal dhe presim që partneriteti ynë të jetë i ndërsjellë. Presim që Serbia të angazhohet me NATO-n dhe fqinjët e saj në mënyrë konstruktive. Për këtë çështje, sekretari i përgjithshëm i NATO-s vazhdon të jetë në kontakt me presidentin Vuçiq", tha një zyrtar i NATO-s.

Kosova ka ngritur aktakuzë ndaj 45 personave, përfshirë Radoiçiqin, për sulmin në Banjskë. Gjykimi është mbajtur vetëm ndaj tre personave, të cilët janë dënuar nga shkalla e parë e gjyqësorit: një me 30 vjet burgim dhe dy persona me burgim të përjetshëm.

KRU "Prishtina" bën thirrje për pagesën e faturave: Borxhi ka arritur në 47 milionë euro

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Prishtina" u ka bërë thirrje konsumatorëve që t'i paguajnë me kohë faturat e ujit, duke theksuar se borxhi i akumuluar ka arritur në 47 milionë euro.

Kompania ka vlerësuar se niveli i

borxhit po ndikon në funksionimin e shërbimit të ujësjellësit. "Borxhi prej 47 milionë eurosh është i papranueshëm dhe dëmton funksionimin e shërbimit të ujësjellësit", thuhet në njoftimin e kompanisë.

Ujësjellësi "Prishtina" ka theksuar se pagesa e rregullt e faturave është përgjegjësi e secilit konsumator dhe se shmangia e akumulimit të borxheve është në interes të qytetarëve dhe të një shërbimi të qëndrueshëm të furnizimit me ujë.



DHTIK kërkon ndërhyrje urgjente për zhbllokimin e procedurave të pronës publike

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Kosovë i është drejtuar kryeministrit të Kosovës dhe ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me kërkesë për ndërhyrje urgjente për zhbllokimin e procedurave që lidhen me shfrytëzimin e pronës publike dhe për përsheptimin e ndryshimeve në Ligjin për Pronën Publike. DHTIK shpreh shqetësimin e saj për vonesat dhe pengesat administrative me të cilat po përballen bizneset, e cila po ndikon negativisht në aktivitetin ekonomik, humbje të tregut, të vendeve të punës, të investimeve dhe sigurinë juridike të bizneseve.

Pavarësisht se Qeveria e Kosovës ua ka dhënë dritën e gjelbër tri kompanive që të marrin në shfrytëzim pronën publike, ato vazhdojnë të përballen me pengesa që ua pamundësojnë fillimin e aktivitetit, pasi Agjencia e Pyjeve të Kosovës i ka kushtëzuar kontratat me përfundimin e procedurës për ndërrimin e destinimit të tokës. Kjo procedurë do të duhej të përfundonte para nënshkrimit të kontratave. DHTIK thekson se, për shkak të mosfinalizimit të këtyre procedurave, kompanitë nuk kanë mundur të vazhdojnë me marrjen e lejeve të nevojshme pranë Komisionit të Pavarur



për Miniera dhe Minerale (KPM), duke mbetur të bllokuara edhe pas marrjes së kontratave. Një nga shqetësimet kryesore të ngritura është kompleksiteti i procedurave. Për shkak të burokracisë së theksuar, një biznes mund të presë pothuajse një vit për përfundimin e procesit të marrjes së lejes për shfrytëzimin e pronës publike.

“Janë me qindra kërkesa të deponuara prej kohësh në Agjencinë e Pyjeve të Kosovës, të cilat vazhdojnë të mos përcillen në Zyrën për Administrimin e Pronës Publike për trajtim të mëtejshëm. Bazuar në të dhënat e Doganës së Kosovës, është evidentuar rritje e vazhdueshme e importit të zhavorrit, ku Serbia prin në listën e vendeve nga të cilat importohet ky material. Për DHTIK-në, vonesat në aktivizimin e kapaciteteve vendore ndikojnë në kostot e kompanive dhe në realizimin e projekteve dhe investimeve”, theksohet në komunikatën për medie.

DHTIK kërkon që procedurat të rishikohen në mënyrë tërësore, me qëllim eliminimin e burokracisë së panevojshme, reduktimin e numrit të institucioneve të përfshira dhe shkurtimeve të afateve për trajtimin e kërkesave. Dhoma e konsideron urgjent përfundimin e ndryshimeve në Ligjin për Pronën Publike si dhe vendosjen e një mekanizmi të qartë të koordinimit ndërinstitutional dhe të përcjelljes së kërkesave, me afate të përcaktuara për secilin institucion, me synim krijimin e një kuadri më të qartë, më efikas dhe më të parashikueshëm për bizneset dhe investitorët.

BQK-JA FORCON BASHKËPUNIMIN ME BANKËN KOMBËTARE TË KROACISË NË FUSHËN E MBROJTJES SË KONSUMATORËVE FINANCIARË

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, u takua me ekspertët e Bankës Kombëtare të Kroacisë, Renata Pustijanac, këshilltare e lartë dhe Iva Bezik, këshilltare në Departamentin për Rregullimin e Mbrojtjes së Konsumatorëve dhe Edukimin Financiar, në kuadër të misionit të parë dypalësh të ekspertëve për Mbrojtjen e Konsumatorëve Financiarë dhe Edukimin Financiar. Misioni u zhvillua në BQK nga 22 deri më 24 shtator 2026, në kuadër të Programit për Forcimin e Kapaciteteve të Bankave Qendrore në Ballkanin Perëndimor, me qëllim të integrimit në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore, Faza III. Ai pasoi kërkesën e BQK-së dhe marrëveshjen e ndërsjellë me Bankën Kombëtare të Kroacisë. Në fillim të misionit, zëvendësguvernatorja Nesrin Shileku-Shala diskutoi aspektet kryesore të projektit, si dhe ecurinë e tij në përputhje me fazat e planifikuara. Vizita përbën një hap të rëndësishëm në forcimin e kornizës mbikëqyrëse të BQK-së për mbrojtjen e konsumatorëve financiarë, mbikëqyrjen e sjelljes në treg dhe edukimin financiar, duke mbështetur harmonizimin e vazhdueshëm të institucionit me standardet dhe praktikën më të mira evropiane. Gjatë misionit palët diskutuan



kornizën rregullative, mbikëqyrëse dhe institucionale për mbrojtjen e konsumatorëve financiarë dhe mbikëqyrjen e sjelljes në treg. Vëmendje e veçantë iu kushtua edukimit financiar, trajtimit të ankesave, kërkesave për raportim, cilësisë së të dhënave, procedurave mbikëqyrëse dhe zhvillimit të një qasjeje të bazuar në rrezik për mbikëqyrjen e sjelljes në treg. Në këtë kontekst, guvernatori Ismaili theksoi se mbrojtja e konsumatorëve financiarë, transparenca e tregut dhe besimi i publikut në sistemin financiar mbeten prioritetet strategjike për BQK-në. Ai nënvizoi se forcimi i mbikëqyrjes së sjelljes në treg,

përmirësimi i përdorimit të të dhënave mbikëqyrëse dhe sigurimi i trajtimit të drejtë dhe transparent të konsumatorëve janë komponentë thelbësorë të një kornize moderne dhe efektive mbikëqyrëse. “Mbrojtja e konsumatorëve financiarë është thelbësore për ruajtjen e besimit në sektorin financiar. Përmes zhvillimit të mëtejshëm të kornizës sonë rregullative dhe mbikëqyrëse, synojmë të sigurojmë transparencë më të madhe, praktika të përgjegjshme të tregut dhe mekanizma efektivë për adresimin e shqetësimeve të konsumatorëve. Përvoja dhe mbështetja e Bankës Kombëtare të Kroacisë japin një kontribut të rëndësishëm në këtë proces dhe në harmonizimin

tonë gradual me standardet dhe praktikën evropiane”, ka deklaruar guvernatori Ismaili. Përfaqësueset e Bankës Kombëtare të Kroacisë paraqitën përvojën e tyre në mbikëqyrjen e sjelljes në treg, monitorimin e mbrojtjes së konsumatorëve financiarë, trajtimin e ankesave dhe edukimin financiar. Diskutimet përfshinë, gjithashtu, mbledhjen dhe vlerësimin e të dhënave, proceset e mbikëqyrjes nga distanca dhe në terren, si dhe përdorimin e mjeteve mbikëqyrëse për identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të sjelljes në treg. Guvernatori Ismaili shprehu mirënjohje ndaj Bankës Kombëtare të Kroacisë dhe ekspertëve të saj për mbështetjen

profesionale dhe bashkëpunimin konstruktiv. Ai rikonfirmoi përkushtimin e BQK-së për shndërrimin e rekomandimeve të misionit në përmirësime konkrete në procedurat mbikëqyrëse, raportim, analizë të rrezikut, përdorim të të dhënave dhe mbrojtje të konsumatorëve financiarë. Ky bashkëpunim dypalësh forcon kapacitetet institucionale dhe mbikëqyrëse të BQK-së, mbështet harmonizimin e saj të vazhdueshëm me standardet e Bashkimit Evropian dhe praktikën e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore, me ç'rast BQK-ja shpreh mirënjohjen e saj për mbështetjen e ofruar përmes këtij kuadri të rëndësishëm bashkëpunimi.

Miratohet buxheti i Mitrovicës për vitin 2027, mbi 34 milionë euro

MITROVICË, 25 SHTATOR - Kuvendi Komunal i Mitrovicës ka miratuar buxhetin komunal për vitin 2027 në vlerë prej 34 milionë e 45 mijë e 130 eurosh. Kryetari i Mitrovicës, Faton Peci, ka bërë me dije se ky buxhet, së bashku me projektet dhe

mbështetjen e qeverisë, pritet të jetë buxheti më i lartë në historinë e komunës. Sipas Peci, mjetet e planifikuara do të orientohen në projekte të reja, investime dhe shërbime për qytetarët. “Miratohet Buxheti Komunal për vitin 2027 në vlerë

prej 34,045,130 euro për Mitrovicën. Bashkë me projektet dhe mbështetjen e Qeverisë, do të jetë buxheti më i lartë në histori të Mitrovicës. Për projekte të reja, investime dhe shërbime për qytetarët tanë”, ka shkruar Peci.



ALEKSANDRI PUSHTONTE BOTËN. E ËMA, OLIMPIA ELIMINONTE RIVALËT DHE SIGURONTE FRONIN



Aleksandri i Madh është një nga figurat më të njohura të botës së lashtë. Në vetëm 13 vjet ai krijoi një perandori madhështore, e cila shtrihej në tri kontinente dhe kishte deri në 50 milionë banorë. Ishte një udhëheqës ushtarak i aftë, ambicia e të cilit nuk njihje kufij. Por a do të kishte mundur Aleksandri të arrinte gjithçka që arriti pa ata që i qëndruan pranë? Një nga mbështetëset dhe këshilltaret e tij më të rëndësishme ishte e ëma, Olimpia e Maqedonisë: një grua që do të dëshmonte se ishte një nga nënat më të përkushtuara të historisë dhe një nga figurat politike më magjepsëse e më të frikshme të lashtësisë.

OLIMPIA, MBRETËRESHA E MAQEDONISË

Olimpia e Maqedonisë nuk e nisi jetën me këtë emër të famshëm. Ajo lindi si princeshë në familjen mbretërore të molosëve dhe u quajt Poliksena. I ati, Neoptolemi I, sundonte mbi molosët e Epirit, një fis ilir që banonte në territoret në perëndim të mbretërisë së lashtë të Maqedonisë. Krahas prejardhjes së saj mbretërore, Olimpia këmbëngulte se rridhte edhe nga disa prej figurave më të famshme të historisë dhe mitologjisë: Helena e Trojës, gruaja më e bukur në botë, dhe Akili, heroi tragjik i Luftës së Trojës.

Sipas veprës “Jeta e Aleksandrit” të Plutarkut, Olimpia e takoi për herë të parë mbretin Filipi II të Maqedonisë në ishullin grek të Samotrakës, ku edhe ra në dashuri me të. Takimi ndodhi teksa të dy po pranoheshin, përmes riteve të inicimit, në kultin fetar të njohur si Misteret e Samotrakës. Natyra e vërtetë e ritualeve të këtij kulturi nuk është zbuluar kurrë nga historianët, megjithëse rrënojat e Shenjtërores së Perëndive të Mëdha qëndrojnë ende në ishull. Përkatesia në një bashkësi fetare nuk ishte diçka e huaj për Olympian, e cila thuhet se ishte gjithashtu pjesëtare e kultit po aq enigmatik të Dionisit. Ashtu si për shumë figura të botës së lashtë, jeta e saj ishte e lidhur pazgjidhshmërisht me fenë dhe mitologjinë. Kur u inicua në Samotrakë, Olimpia e ndryshoi emrin nga Poliksena në Mirtale. Në kohën kur Filipi dhe Olimpia u njohën, u ra dakord për martesën mes tyre. Kur u zhvillua dasma, në vitin 357 p.e.s., Olimpia ishte rreth 18 vjeçe. Marrëdhënia e çiftit mbretëror rezultoi e trazuar, pasi temperamenti i zjarrtë dhe ambicia e fortë e Olympias përplaseshin me natyrën e paparashikueshme të Filipit. Olimpia nuk ishte gruaja e parë e Filipit dhe jeta e tij poligame, me disa bashkëshorte, ngjallte tek ajo një xhelozë të fortë. Ndonëse mund ta kenë nisur jetën martesore si një çift i dashuruar, thuhet se Filipit iu

shuan shpejt përfytyrimet romantike për Olympian, kur e gjeti duke fjetur përkrah gjarpërinjë, një veprim që mund të lidhej me përfshirjen e saj në kultin e Dionisit. Sipas Plutarkut, kjo ngjarje e bëri Filipin të druhej se Olimpia ishte një magjistare ose bashkëshorte e një hyjnie. Vitin pasues, në jetën e Olympias ndodhën dy ndryshime të mëdha. Së pari, i shoqi i dha një emër të ri. Pas fitores së njërit prej kuajve të Filipit në Lojërat Olimpikë, emri i saj u ndryshua nga Mirtale në Olimpia, emri me të cilin njihet më së shumti sot. Së dyti, atë vit ajo solli në jetë fëmijën e saj të parë, i cili një ditë do të sundonte perandorinë më të fuqishme të botës. Ky fëmijë, Aleksandri, do të përcaktonte qëllimin e jetës së Olympias.

ALEKSANDRI, FORMIMI I NJË MBRETI

Thuhet se, kur u martua, Olimpia pa një ëndërr në të cilën një rufe godiste mitrën e saj dhe ndizte një flakë. Edhe Filipi thuhet se pa një ëndërr, në të cilën vuloste mitrën e gruas së tij të re me figurën e një luani. Të dyja këto vegime u interpretuan si ogure të ardhjes në jetë të një fëmije të fortë dhe me ndikim. Dhe duket se ëndrrat u vërtetuan kur lindi Aleksandri, i cili më vonë do të njihet si Aleksandri i Madh. Që nga lindja e tij, pranohej se

Aleksandri do të ishte trashëgimtari i mbretërisë së të atit, pavarësisht se kishte vëllezër e motra më të mëdhenj nga gratë e tjera të Filipit. Me ngritjen e statusit të Aleksandrit u forcua edhe pozita e Olympias. Ajo u bë gruaja më e rëndësishme e Filipit, duke zënë praktikisht vendin e bashkëshortes kryesore. Si nëna e udhëheqësit të ardhshëm të Maqedonisë, Olimpia bëri gjithçka munda për të lartësuar emrin e të birit. Thuhet se, kur u rrit, Aleksandri pretendonte se ishte biri i perëndisë Zeus, një ide që mund t’ia kishte ngulitur e ëma. Plutarku shkruan se Olimpia pretendonte që Zeusi e kishte lënë shtatzënë përmes rrufesë që kishte parë në ëndërr, ndërsa versione të tjera të rrëfimit sugjerojnë se një gjarpër në shtratin e saj ishte në të vërtetë vetë Zeusi i maskuar. Me Filipin të zënë me çështjet e politikës së jashtme e të brendshme dhe me lidhjet e tij të shumta dashurore, Olympias i mbeti përgjegjësia për të rritur Aleksandrin dhe për ta përgatitur për jetën si mbret. Për shumë vjet ajo u kujdes për arsimimin e tij dhe u sigurua që të rritej po aq ambicioz sa ajo.

GRUAJA E RE E FILIPIT

Rreth vitit 355 p.e.s., Olimpia solli në jetë fëmijën e saj të dytë me Filipin, një vajzë të quajtur

Kleopatra. Olimpia e gëzonte pozitën e saj si nëna e trashëgimitarit dhe ia kushtonte kohën përkujdesjes që fëmijët e saj të rriteshin të aftë e të zgjuar, të zotë për të vepruar me sukses në botën politike ku kishin lindur. Megjithatë, kjo qetësi mori fund papritur në vitin 337 p.e.s., kur Filipi u martua me një grua të re. Kleopatra Euridika përbënte kërcënim për pozitën e Olympias, sepse, ndryshe nga të gjitha gratë e tjera të tij, ajo nuk ishte një e huaj me të cilën martesë ishte lidhur për të krijuar aleancë politike mes mbretërive ose për të zgjeruar perandorinë në rritje të mbretit. Gruaja e re e Filipit ishte maqedonase dhe, pa dyshim, do të gëzonte më shumë përkrahje nga Filipi dhe nënshitetasit e tij sesa një e huaj si Olimpia. Marrëdhëniet mes Olympias, Filipit dhe Kleopatra Euridikës u përkeqësuan më tej gjatë festimeve të dasmës së çiftit të ri, kur një i afërm i nuses ngriti një dolli që nënkuptonte se nga kjo martesë do të lindte një trashëgimtar i ligjshëm për Filipin. Kur dëgjoi këtë thumbim ndaj legjitimitetit të tij, Aleksandri thuhet se shpërtheu në britma zemërimi dhe u nis të përballë me burrin, por u ndal nga i ati i dehur. Teksa po merrte shpatën, Filipi u pengua dhe ra, duke u bërë objekt talljeje për Aleksandrin. Kjo ngjarje vetëm sa e largoi edhe më shumë Aleksandrin nga i ati dhe Olimpia e mori menjëherë me

vete nga Maqedonia në Molosi, derisa gjendja të qetësohej. Aleksandri u kthye në Maqedoni vitin pasues dhe, me sa duket, e ndreqi marrëdhënien me të atin. Olimpia, nga ana tjetër, nuk duket se ishte po aq e gatshme të falte dhe nuk e shoqëroi të birin në kthimin e tij. Nuk dihet ku jetoi gjatë kësaj kohe, por ajo u shfaq në dasmën e së bijës, në vitin 336 p.e.s. Gjatë festimeve, Filipi u përpoq të paraqiste një pamje bashkimi familjar dhe paqeje brenda shtëpisë mbretërore, por ngjarjet morën një kthesë të papritur e tronditëse kur ai u godit brutalisht për vdekje me thikë nga truproja e tij, Pausania i Orestidës. Motivet e vërteta të vrasjes së Filipit nuk janë zbuluar kurrë. Pausania u kap dhe u vra pothuajse menjëherë pas atentatit, ndaj nuk mundi të jepte shpjegime. Megjithatë, disa burime hedhin idenë se truproja kishte qenë i dashuri i mbretit dhe se ishte mbushur me pakënaqësi pas një mosmarrëveshjeje personale ose politike. Historianë të mëvonshëm, ndërkaq, kanë hamendësuar se pas vrasjes qëndronte Olimpia. Me Filipin të vdekur, Aleksandri do të ishte i lirë të merrte fronin e Maqedonisë dhe të siguronte pozitën e të dyve. Për më tepër, thuhet se më vonë Olimpia e nderoi Pausanian, vrasësin e të shoqit. Përse do ta bënte këtë, nëse nuk kishte qenë e përfshirë në atentat? Nëse Olimpia kishte qenë fshehurazi përgjegjëse për këtë vrasje, shumë shpejt do ta shfaqte hapur përpara botës ambicien e saj mizore.

NJË EPOKË E RE E PËRGJAKSHME

Aleksandri e përvetësoi rolin e mbretit me lehtësi të natyrshme, pikërisht siç kishte synuar e ëma. Ai ishte autoritar e i aftë dhe iu përvesh menjëherë zgjerimit të

perandorisë maqedonase, themelet e së cilës i kishte hedhur i ati. Olimpia, si Nënë Mbretëreshë, i mori seriozisht përgjegjësitë e saj dhe u sigurua që brenda vendit të mos kishte kërcënime as ndaj fronit të të birit, as ndaj autoritetit të saj. Sapo mori kurorën, Aleksandri urdhëroi pa vonesë vrasjen e armiqve të tij politikë dhe e ëma u kujdes ta ndihmonte. Tani që i shoqi kishte vdekur, një nga vendimet e para dhe më tronditëse të Olimpias ishte të urdhëronte vrasjen e gruas së fundit të Filipit, Kleopatra Euridikës, dhe të foshnjës së saj. Historianët nuk janë të sigurt nëse Aleksandri ishte në dijeni të synimeve të pamëshirshme të së ëmës, por, sidoqoftë, Olimpia nuk do të rrezikonte që një trashëgimtar tjetër të sfidonte sundimin e të birit. Kur Aleksandri u largua në fushata ushtarake, emëroi një regjent për të mbikëqyrur Maqedoninë. Antipatri, një gjeneral që kishte shërbyer nën Filipin, u përzgjedh për përvojën, aftësitë dhe besnikërinë ndaj familjes mbretërore. Ndonëse Olimpia nuk u emërua regjente, ajo vazhdonte të ushtronte pushtet real mbi Maqedoninë, si sytë e Aleksandrit në atdhe. Dihej gjithashtu se zhvillonte bisedime me shtete të tjera në emër të Maqedonisë, gjë që Antipatri nuk e priste mirë. Armiqësia mes tyre dukej qartë në letrat e ankesave që të dy i dërgonin Aleksandrit gjatë qëndrimit të tij jashtë vendit. Megjithatë, Aleksandri vazhdonte të merrte këshilla nga e ëma në largësi dhe, me gjasë, i pëlqente fakti që ajo mbante nën vëzhgim Antipatrin për llogari të tij.

LUFTA PËR PUSHTET

Në vitin 323 p.e.s., Aleksandri vdiq papritur, pas vetëm 13 vjetësh në fron. Pa dyshim, Olimpia u dërmua nga humbja e të birit, të cilit i kishte kushtuar jetën dhe tek

i cili ishte mbështetur. Vdekja e tij tronditëse e zhyti perandorinë në kaos, ndërsa shpërtheu Lufta e Pasardhësve. Gjeneralë dhe pretendentë për fronin maqedonas, të njohur si diadokët, luftuan kundër njëri-tjetrit për të shtënë në dorë territoret e Aleksandrit, duke e copëtuar perandorinë e stërmadhe në pjesë më të vogla në kërkimin e tyre për pushtet. Përfundimisht, ndërsa perandoria po shpërbëhej, u vendos që djali foshnjë i Aleksandrit, Aleksandri IV, dhe gjysmëvëllai i Aleksandrit, Filipi III, për të cilin historianët mendojnë se mund të ketë pasur vështirësi në të nxënë, të sundonin bashkërisht Maqedoninë nën një regjencë. Regjenca do të përfundonte kur Aleksandri IV të arrinte moshën madhore. Kuptohet që Olimpia donte të sigurohej se do të ruante njëfarë kontrolli mbi fronin përmes nipit të saj të vogël dhe nisi të vepronte për të gjetur një regjent që do ta mirëpriste përfshirjen e saj. Më në fund u përzgjedh Perdika, një gjeneral i Aleksandrit të Madh. Duke e ditur se duhej të krijonte aleancë me të, Olimpia e martoi menjëherë të bijën, Kleopatrën, me Perdikën. Antipatri u tërbua që ishte anashkaluar, si edhe nga fakti se Perdika kishte shmangur propozimin për t’u martuar me vajzën e tij, Nikenë. Ai mblodhi aleatë, e rrëzoi shpejt Perdikën dhe u vendos vetë në postin e regjentit. Sigurisht, Olimpia ishte e pakënaqur me këtë zgjidhje të re, për shkak të marrëdhënies së saj tashmë të tensionuar me Antipatrin. Nuk mund të bënte shumë për ta ndryshuar gjendjen dhe, duke ndier se e kishte humbur betejën, u tërhoq në Molosi. Por zhgënjimi i Olimpias u fashit shpejt, kur Antipatri vdiq më pak se një vit më vonë, duke e lënë sërish vakant postin e

regjentit. Në vend që t’ia kalonte këtë titull të birit, Kasandrit, Antipatri ia kishte besuar detyrën një gjenerali tjetër, të quajtur Poliperkon. Ky i sugjeroi Olimpias të kthehej në Maqedoni për të udhëzuar nipin e saj. Kasandri, megjithatë, kishte plane të tjera dhe nisi përgatitjet për t’ia marrë regjencën Poliperkonit.

LUFTA MES GRAVE

Gjatë kohës që Olimpia qëndronte larg Maqedonisë, Filipi III, bashkësundimtari i Aleksandrit IV, ishte martuar me një grua, ambiciet e së cilës ishin po aq të mëdha sa të sajat. Adea Euridika ishte një kundërshtarë e frikshme, që kërkonte pushtet absolut për veten dhe për bashkëshortin e saj të ri dhe ishte e gatshme të bënte gjithçka për të hequr qafe Aleksandrin IV. E vetëdijshme për kthimin e afërt të Olimpias, Adea Euridika lidhi aleancë me Kasandrin dhe nisi përgatitjet për t’u përballur me forcat e Olimpias dhe të Poliperkonit. Në vitin 317 p.e.s., forcat e Olimpias u gjendën ballë për ballë me ushtrinë e Adea Euridikës, në kufirin mes Maqedonisë dhe Molosisë. Në krye të ushtrive të tyre, të dyja gratë u përballën me njëra-tjetrën: Olimpia thuhet se mbante veshjen e një priftëreshe të Dionisit, ndërsa Adea Euridika ishte veshur si ushtarë. Historiani i lashtë grek, Durisi i Samosit, e përshkroi këtë përballje si “luftën e parë mes grave”. Por, në një kthesë befasuese, ushtarët e Adea Euridikës refuzuan të luftonin kundër fuqisë së Olimpias dhe kaluan shpejt në anën tjetër, pa nisur ende beteja. Prania e Olimpias ishte, me sa duket, mjaft kërcënuese për të frikësuar një ushtri të tërë dhe për t’i shtyrë ushtarët të shpërfillnin urdhrat e komandantes së tyre. Adea Euridika dhe Filipi III u

burgosën menjëherë pas kryengritjes së dështuar dhe, siç e kishte zakon Olimpia, nuk u tregua asnjë mëshirë. Disa burime tregojnë se Olimpia urdhëroi ekzekutimin e çiftit, ndërsa të tjera thonë se e detyroi kundërshtaren e saj të vriste veten. Sido që të ketë ndodhur, fundi erdhi shpejt për Adea Euridikën dhe bashkëshortin e saj fatkeq. Olimpia urdhëroi gjithashtu vrasjen e vëllait të Kasandrit dhe të rreth 100 përkrahësve të tij. Kasandri u kundërpërgjigj me tërbim, duke i detyruar Olympian, Aleksandrin e vogël dhe të ëmën e tij, Roksanën, të tërhiqeshin në Pidna të Maqedonisë. Atje, forcat e Kasandrit e rrethuan qytetin për muaj me radhë, derisa Olimpia nuk pati zgjidhje tjetër përveçse të dorëzohej, në fillim të vitit 316 p.e.s. Kasandri i premtoi se, nëse dorëzohej, do t’ia kursente jetën, por pak pas dorëzimit e shkeli zotimin e tij. Megjithatë, nami i frikshëm i Olimpias e bëri të ndihej për herë të fundit: ushtarët e Kasandrit refuzuan ta ekzekutonin, duke e detyruar atë t’ua besonte të tjerëve vrasjen e saj. Ai u ofroi të afërmve të njerëzve që Olimpia kishte vlarë mundësinë për t’i dhënë fund jetës së saj. Kështu, Olimpia u vra me gurë nga ata që kishte goditur. Kasandri mbeti regjent i Aleksandrit IV deri në vitin 309 p.e.s., kur urdhëroi vrasjen e mbretit të ri dhe të së ëmës dhe e mori fronin për vetë. Trashëgimia e Olimpias është përcaktuar prej kohësh nga mizoritë që kreu gjatë jetës. Ajo është etiketuar si vrasëse, por kjo nuk duket e drejtë. Po, ajo ishte e pamëshirshme, mizore, por të tillë ishin edhe burrat që e rrethonin. A do të etiketohej në të njëjtën mënyrë ndonjëri prej burrave në pozita të ngjashme me të? / bota.al





SAINT-GOBAIN
SEKURIT
Enveri
PILKINGTON

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com





QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

KOSOVA E NIS ME FITORE EDICIONIN NË LIGËN B TË LIGËS SË KOMBEVE

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Kombëtarja e Kosovës e ka nisur me fitore aventurën në Ligën B të Ligës së Kombeve, duke mposhtur Irlandën me rezultat 1:0 në stadiumin “Fadil Vokrri” në Prishtinë. “Dardanët” kanë zhvilluar një ndeshje të shkëlqyer dhe gjatë gjithë takimit ishin më kërkues, duke krijuar një sërë mundësish për gol. Hero i fitores ishte kapiteni Vedat

një mundësi të mirë në minutën e 56, por ka goditur pranë shtyllës. Në minutën e 86 Krasniqi nga një pozitë tejet e volitshme ka gjuajtur pranë portës. Një minutë më vonë Veldin Hoxha, pas asistimit të Krasniqit, ka gjuajtur nga vija e 16-metërshit, por topi ka shkuar afër portës. Në minutën e 89 Fisnik Asllani ka asistuar për Leon Avdullahun në brendësi të zonës, por portieri ka reaguar me kohë.

të Ligës së Kombeve. Ademi i ka përgëzuar futbollistët dhe përzgjedhësin Franco Foda, duke vlerësuar paraqitjen e “Dardanëve” në stadiumin “Fadil Vokrri”. “Përveç lojës së Kombëtares dhe atmosferës fantastike të krijuar nga ‘Dardanët’, nga tribunat dhe në fushë u përcoll edhe një mesazh i fuqishëm në mbështetje të çlirimtarëve tanë. Një mesazh që na kujton se liria jonë ka një histori, sakrificë dhe emra që nuk harrohen. Përgëzime për secilin futbollist për angazhimin, karakterin dhe përkushtimin e treguar gjatë 90 minutave. Mirënjohje për përzgjedhësin Franco Foda dhe gjithë stafin teknik për punën dhe përkushtimin e tyre”, ka shkruar Ademi në rrjetet sociale. Krahas fitores, Ademi ka thënë se Kosova ka fituar edhe në unitet, krenari dhe dashuri për Kosovën. “Liria ka Emër! Për çlirimtarët!”, ka shkruar Ademi.

MURIQI: FITOREN UA DEDIKOJ ÇLIRIMTARËVE TANË, KRERËVE TË UÇK-së

Vedat Muriqi ka qenë vendimtar në fitoren e Kosovës ndaj Irlandës në ndeshjen hapëse të Ligës së Kombeve, ndërsa pas ndeshjes ua ka dedikuar triumfin krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Sulmuesi i Kosovës ka vlerësuar rëndësinë e nisjes së ciklit të ri të Ligës së Kombeve me fitore, veçanërisht para tifozëve në stadiumin “Fadil Vokrri”. “Duke marrë parasysh që kemi nisur një cikël të ri të Ligës së Kombeve për kombëtaren tonë, ka qenë me rëndësi që lojën e parë para shikuesve tanë të fitojmë”, ka thënë Muriqi për “Klan Kosova”. Ai ka theksuar se skuadra i ka identifikuar pikat e dobëta të Irlandës dhe ka arritur ta mbajë ndeshjen nën kontroll. “I kemi ditë pikët e dobëta të Irlandës. Jemi munduar me e pasë lojën në kontroll dhe besoj që e kemi pasë tërë kohën”, është shprehur Muriqi. Sulmuesi i ka falënderuar bashkëlojtarët, shtabin teknik, atë mjekësor dhe tifozët për kontributin në këtë fitore. “Me rëndësi ka qenë fitorja. E përgëzoj gjithë ekipin, shtabin teknik, shtabin mjekësor. U lumshin këmbët, duart e goja gjithë tifozëve tanë që kanë qenë këtu”, ka deklaruar ai. Në fund Muriqi ka bërë edhe dedikimin e tij për ish-krerët e UÇK-së. “Fitoren, veçanërisht ua dedikoj çlirimtarëve tanë, krerëve të UÇK-së”, ka deklaruar Muriqi.



Muriqi, i cili ka shënuar golin vendimtar në minutën e 83-të. Pas një aksioni të mirë të nisur nga Ermal Krasniqi, goditja e tij është devijuar dhe topi ka përfunduar në traversë, ndërsa Muriqi ka reaguar shpejt në topin e kthyer dhe nga afërsia e ka dërguar në rrjetë me gjuajtje me kokë për 1:0. Sulmuesi i Kosovës gjatë ndeshjes ka pasur edhe dy raste të tjera për të shënuar. Në minutën e 28 Jayson Molumby e ka larguar topin nga vija e portës pas goditjes së Muriqit, ndërsa pak para përfundimit të pjesës së parë portieri irlandez Caoimhin Kelleher ka bërë një pritje të shkëlqyer pas goditjes me kokë të kapitenit të Kosovës. Edhe Veldin Hoxha ka pasur një mundësi të artë në pjesën e parë, por goditja e tij është ndalur në vijën e portës nga Dara O’Shea. Në pjesën e dytë Irlanda ka pasur një rast të mirë përmes Troy Parrott, por portieri Arijanet Muriqi ishte në vendin e duhur për ta ndalur goditjen me kokë të sulmuesit irlandez. “Dardanët” në pjesën e dytë kanë pasur shumë raste, sidomos në minutat e fundit. Edon Zhegrova ka pasur

Në vazhdim të aksionit Erblin Osmani ka gjuajtur, por topi është devijuar nga mbrojtësi irlandez. Dominimin e Kosovës e dëshmojnë edhe statistikat e ndeshjes. “Dardanët” kanë regjistruar 21 goditje drejt portës, kundrejt vetëm tri tentimeve të Irlandës. Kjo ndeshje ishte e veçantë edhe për debutimin e talentit 17-vjeçar të Bayern Munit, Erblin Osmani. Atmosfera nga tifozët “Dardanët” ishte e shkëlqyeshme, të cilët në fillim të ndeshjes kanë pasur një mesazh të fuqishëm “Unitet. Çlirim. Krenari”, në shenjë mbështetjeje për çlirimtarët në Hagë. Ndeshjen e radhës “Dardanët” do ta zhvillojnë nesër (e diel) nga ora 18:00 në Vjenë kundër Austrisë.

Ademi pas fitores ndaj Irlandës: Fituam në fushë, por edhe në unitet e krenari

Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, ka reaguar pas fitores së Kosovës ndaj Irlandës në ndeshjen hapëse



KOSOVA NË FOKUSIN E FIFA-S, SANIJE KRASNIQI FLET PËR AKADEMINË E TALENTEVE DHE TË ARDHMEN E FUTBOLLIT

FIFA Training Centre ka publikuar një intervistë me Sanije Krasniqin, drejtoreshën e Edukimit të Trajnerëve në Federatën e Futbollit të Kosovës dhe udhëheqësen e FIFA Talent Academy për Kosovën. Në intervistën e publikuar më 24 shtator, Krasniqi ka folur për rëndësinë e bashkëpunimit, shkëmbimit të njohurive dhe krijimit të një rruge të qëndrueshme për zhvillimin e talenteve kosovarë. “Dua të sigurohem që njohuritë dhe metodologjia që marrim përmes bashkëpunimit me FIFA-n të shpërndahen përtej Akademisë në mënyrë që projekti të ketë ndikim më të gjerë në zhvillimin e futbollit në Kosovë”, ka thënë Krasniqi për FIFA Training Centre.

FIFA ka veçuar edhe ritmin e realizimit të projektit, pasi FIFA Talent Academy në Kosovë është lansuar në shtator të vitit 2026, vetëm nëntë muaj pas nisjes së tij. Akademia aktualisht përfshin 40 futbollistë të grupmoshës U-14, 20 djem dhe 20 vajza. Krasniqi ka theksuar se synimi nuk është vetëm identifikimi i talenteve, por krijimi i një sistemi që lidh Akademinë, klubet, trajnerët dhe ekipet kombëtare. “Një tjetër kriter i rëndësishëm i suksesit është nëse njohuritë dhe metodologjia e projektit bëhen pjesë e federatës dhe ndahen me trajnerët dhe klubet”, ka deklaruar ajo. Krasniqi ka folur edhe për përvojën e saj në FIFA Technical Leadership Diploma, duke thënë se programi ka ndikuar në zhvillimin e aftësive të saj në lidhshmëri, bashkëpunim dhe vendimmarrje. “Për mua ky është një shembull i shkëlqyer se si mësimet nga FIFA Technical Leadership Diploma mund të aplikohen drejtpërdrejt në punën tonë të përditshme dhe të krijojnë ndikim real”, ka deklaruar Krasniqi.





N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail..contact@pallatirinese.com
www.pallatirinese.com



Në bazë të dispozitave të nenit 21, pikës 21.4 të Ligjit nr. 03/L- 087 Për Ndërmarrjet Publike, gjegjësisht nenit 13 të Ligjit nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike dhe në bazë të nenit 17 të Statutit, Bordi i Drejtorëve i N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A., me datë 11.09.2026 bazuar mbi Vendimin Nr. 1/2058 publikon këtë:

KONKURS PUBLIK
Për plotësimin e një (1) pozite

1. Titulli i punës: Këshilltar/e i/e Përgjithshëm – Sekretar/e Korporativ/e
Vendi: Prishtinë.

Ndërmarrja: N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. me seli në Prishtinë.
I përgjigjet: Bordit të Drejtorëve.
Mandati: 3 vite
Koeficienti: 5.9

2. Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Bordi i Drejtorëve, dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të lartë të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, (ii) i plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2, pikat (d), (f), (j), (k) dhe (l) (iii) nuk janë, ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës tridhjetë e gjashtë (36) muajsh para datës së aplikimit nuk kanë qenë Drejtorë të Bordit të kompanisë gjegjëse dhe (iv) kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë; Çdo person i cili dëshiron të merret parasysh për një pozitë të drejtorit duhet që po ashtu t’i përmbushë edhe kushtet e përshtatshmërisë profesionale në vijim:

- Të posedojë diplomë universitare -Fakulteti Juridik (jurist i diplomuar ose master në shkenca juridike);
- Të posedojë së paku pesë (5) vite përvojë profesionale nga fusha e qeverisjes korporative ose të drejtës së shoqërive tregtare;
- Të plotësojë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1 si dhe të plotësojë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat (d),(f),(j),(k),(l) të Ligjit nr. 03/L -087 të Ndërmarrjeve Publike dhe Plotësim Ndryshimit të LNP nr. 04/L-111 neni 13;
- Aftësi për punë ekipore;
- Të ketë aftësi të mira komunikuese;
- Të ketë etikë në punë dhe integritet.
- Të posedojë njohuri të punës me kompjuter;
- Njohja e gjuhës angleze (e dëshirueshme);
- Dëshmitë mbi njohuritë dhe të arriturat tjera do të mirren në konsideratë dhe vlerësohen konform relevancës me vendin e punës;
- Të jetë person me integritet të lartë dhe të plotësojë të gjitha kushtet e përshtatshmërisë të parapara me neni 17 të Ligjit të Ndërmarrjet publike nr. 03/L-087 , dhe plotësim ndryshimet përkatëse,Ligji për Parandalimin e konfliktit të interes në ushtrimin e funksionit public nr/06L-011, si dhe me normat tjera positive relevante.

3. Këshilltar/e i/e Përgjithshëm – Sekretar/e Korporativ/e ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- Sigurohet që të përcillen procedurat e Bordit, ku bëjnë pjesë organizimi i takimeve të Bordit, Komiteteve të Bordit dhe Aksionarëve duke përfshirë (në bashkëpunim me Kryesuesin) përgatitjen dhe shpërndarjen e agjendave;
- Mban regjistrin e aksionarëve;
- Koordinon me KE përgatitjen e materialit për mbledhjet e Bordit të Drejtorëve;
- Mban procesverbalin e mbledhjeve të Bordit të Drejtorëve dhe Komitetit të Auditimit (nëse nuk kërkohet ndryshe nga kryesuesit e tyre) dhe i regjistron në librat e protokolleve;
- Shpërndan procesverbalet tek drejtorët dhe aksionarët;
- Merret me regjistrimin zyrtar të ndryshimeve të cilat kërkohen sipas ligjit, i regjistron në regjistrin e Kosovës për shoqëritë tregtare dhe emrat tregtarë;
- Sipas udhëzimeve nga Kryesuesi, përgjegjësitë e Sekretarit përfshijnë sigurimin e rrjedhjes së mirë të informatave brenda Bordit dhe komiteteve të tij dhe në mes të Bordit dhe menaxherëve të lartë të Ndërmarrjes;
- Këshillat dhe shërbimet e Sekretarit duhet të jenë në dispozicion të të gjithë drejtorëve i cili njëheri është përgjegjës tek Bordi për të siguruar që përputhen procedurat e Bordit;
- Përcjell ndryshimet ligjore që kanë të bëjnë me ndërmarrjen duke informuar Bordin dhe menaxhmentin e kompanisë për ndryshimet si dhe përgatitë udhëzimet e nevojshme për menaxhmentin e kompanisë.Merret edhe me çështjet tjera të qeverisjes korporative sipas nevojës.

4. Informatë për procedurën e konkurimit

- Kandidatët e interesuar për këtë vend pune duhet të bashkangjesin këto dokumente:
- Formulari i kërkesës për punësim (aplikimit);
- Kopje e letërnjoftimit; CV ; Çertifikata e lindjes;Letër motivimi;
- Dëshmitë mbi Shkollimin dhe kualifikimin profesional e noterizuar;
- Diplomat nga universitetet e huaja duhet të jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe e noterizuar.
- Dëshmi për përvojën e punës/vërtetim i lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimeve në atë pozitë;
- Pasqyrat e kontributeve pensionale (nuk kërkohet për përvoja të punës para themelimit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, dhe për ato përvoja kur punëdhënësit nuk kanë qenë të detyruar të paguajnë në këtë institucion);
- Deklarata nën betim sipas neneve 17.1 dhe 17.2 të Ligjit të NP e cila mundë të shkarkohet nga uebfaqja e Kompanisë;
- Certifikatë nga gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale dhe që nuk është i dënuar për kryerjen e ndonjë vepre penale (jo më e vjetër se 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit);
- Lista e dokumenteve të dorëzuara.

5. Afati i Konkursit:

Konkursi publik është i hapur në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data 11.09.2026 deri më 10.10.2026

Të interesuarit mund t’i dorëzojnë kërkesat (aplikacionet) e tyre me dokumentet tjera relevante në emailin: burimetnjerezore@pallatirinese.com

Formulari për kërkesë (aplikim) dhe Deklarata nën betim, mund të shkarkohen nga web-faqja e N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. me seli në Prishtinë në <http://www.pallatirinese.com/> ose mund të merren në zyrat e Ndërmarrjes.

6. Vërejtje:

Kandidatët me dokumentacion të pakompletuar, të paplotësuar dhe jo-adekuat dhe jashtë afatit të konkurrimit, do të refuzohen.

Do të kontaktohen vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara dhe përfshihen në listën e ngushtë.

NJOFTIM


Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Kings Infra” L.L.C. pronar Kujtim Krasniqi me seli në Malishevë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812188557 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Kings Infra” D.O.O. Kujtim Krasniqi Malishev donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812188557 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Kings Infra” L.L.C. with owner Kujtim Krasniqi with headquarters Malisheva, has come to the decision to quit its business: 812188557 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail..contact@pallatirinise.com
www.pallatirinise.com

Na osnovu odredbi člana 21, tačke 21.4 Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima, odnosno člana 13 Zakona br. 04/L-111 o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima i na osnovu člana 17 Statuta, Upravni odbor N.P.L. PALATI I RINISE AD, od 11.09.2026. godine, na osnovu Odluke Br. 1/2058 objavljuje ovo:

JAVNI KONKURS

Za popunjavanje jedne (1) pozicije

1. Naziv radnog mesta: Generalni savetnik - Sekretar preduzeća
Lokacija: Priština.

Preduzeće: N.P.L. PALATI I RINISE AD sa sedištem u Prištini.

Odgovoran: Upravnom odboru.

Mandat: 3 godine

Koeficijent: 5.9

2. Generalni savetnik - Sekretar preduzeća ima sledeće dužnosti i odgovornosti: Upravni odbor želi da osigura da svi potencijalni kandidati budu osobe visokog integriteta koje ispunjavaju kvalifikacione uslove iz člana 17.1, (ii) ispunjavaju kriterijume nezavisnosti iz člana 17.2, tačke (d), (f), (j), (k) i (l) (iii) nisu, ili u bilo kom trenutku tokom trideset šest (36) meseci pre datuma podnošenja zahteva nisu bili, direktori Upravnog odbora relevantne kompanije i (iv) imaju neophodno stručno iskustvo i obrazovanje potrebno za predmetnu poziciju; Svako lice koje želi da bude razmatrano za poziciju direktora mora takode ispunjavati sledeće uslove stručne podobnosti:

- Posedovati univerzitetsku diplomu - Pravni fakultet (diplomirani pravnik ili master pravnih nauka);
- Posedovati najmanje pet (5) godina stručnog iskustva u oblasti korporativnog upravljanja ili kompanijskog prava;
- Ispunjavati kvalifikacione uslove iz člana 17.1 i ispunjavati kriterijume nezavisnosti iz člana 17.2, tačke (d), (f), (j), (k), (l) Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima i izmene ZJP br. 04/L-111, član 13;

- Sposobnost za timski rad;
- Posedovati dobre komunikacijske veštine;
- Posedovati radnu etiku i integritet.
- Posedovati računarske veštine;
- Znanje engleskog jezika (poželjno);
- Dokazi o drugim znanjima i dostignućima biće uzeti u obzir i procenjeni u skladu sa relevantnošću za posao;
- Biti osoba sa visokim integritetom i ispunjavati sve uslove podobnosti utvrđene članom 17 Zakona o javnim preduzećima br. 03/L-087 i relevantnim izmenama, Zakonom o sprečavanju sukoba interesa u vršenju javnih funkcija br. 06/L-011, kao i drugim relevantnim pozitivnim normama.

3. Generalni savetnik – Sekretar kompanije ima sledeće dužnosti i odgovornosti:

- Osigurati da se poštuju procedure Odbora, uključujući organizaciju sastanaka Odbora, odbora Odbora i akcionara, uključujući (u saradnji sa predsednikom) pripremu i distribuciju dnevnog reda;
- Voditi registar akcionara;
- Koordinirati sa Izvršnom komisijom pripremu materijala za sastanke Odbora direktora;
- Voditi zapisnike sa sastanaka Odbora direktora i Odbora za reviziju (osim ako njihovi predsednici ne zahtevaju drugačije) i evidentirati ih u zapisnicima;
- Distribuirati zapisnike direktorima i akcionarima;
- Obavljati zvaničnu registraciju promena koje zahteva zakon, evidentirajući ih u Kosovskom registru trgovačkih društava i trgovačkih imena;
- Prema uputstvima predsednika, odgovornosti Sekretara uključuju obezbeđivanje nesmetanog protoka informacija unutar Odbora i njegovih odbora i između Odbora i višeg menadžmenta Kompanije;
- Saveti i usluge Sekretara biće dostupni svim direktorima i biće odgovoran Odboru za obezbeđivanje usklađenosti sa procedurama Odbora;
- Prati pravne promene koje se odnose na Društvo tako što obaveštava Upravni odbor i rukovodstvo Društva o promenama i priprema neophodna uputstva za rukovodstvo Društva. Takođe se bavi i drugim pitanjima korporativnog upravljanja po potrebi.

4. Informacije o postupku konkursa

- Kandidati zainteresovani za ovaj posao moraju priložiti sledeća dokumenta:
- Obrazac za prijavu za zaposlenje;
- Kopiju lične karte; CV; Izvod iz matične knjige rođenih;
- Motivaciono pismo;
- Overeni dokaz o obrazovanju i stručnoj kvalifikaciji;
- Diplome stranih univerziteta moraju biti overene od strane Ministarstva prosvete, nauke i tehnologije.
- Dokaz o radnom iskustvu/ potvrda izdata od strane nadležne institucije za zapošljavanje o radnom iskustvu, kojom se utvrđuje radno mesto i trajanje angažovanja na tom mestu;

4. Informacije o postupku konkursa

- Kandidati zainteresovani za ovaj posao moraju priložiti sledeća dokumenta:
- Obrazac za prijavu za zaposlenje;
- Kopiju lične karte; CV; Izvod iz matične knjige rođenih;
- Motivaciono pismo;
- Overeni dokaz o obrazovanju i stručnoj kvalifikaciji;
- Diplome stranih univerziteta moraju biti overene od strane Ministarstva prosvete, nauke i tehnologije.
- Dokaz o radnom iskustvu/ potvrda izdata od strane nadležne institucije za zapošljavanje o radnom iskustvu, kojom se utvrđuje radno mesto i trajanje angažovanja na tom mestu;
- Izjave o penzijskim doprinosima (nisu potrebne za radna iskustva pre osnivanja Kosovskog fonda za penzijsku štednju, i za ona iskustva kada poslodavci nisu bili u obavezi da plaćaju ovoj instituciji);
- Izjava pod zakletvom u skladu sa članovima 17.1 i 17.2 Zakona o JP koja se može preuzeti sa veb stranice Kompanije;
- Potvrda nadležnog suda da se ne vodi krivični postupak i da lice nije osuđivano za bilo koje krivično delo (ne starija od 6 (šest) meseci od datuma izdavanja);
- Spisak podnetih dokumenata.

5. Rok za konkurs:

Javni konkurs je otvoren u periodu od 30 (trideset) dana od 11.09.2026 do 10.10.2026. Zainteresovana lica mogu podneti svoje prijave sa ostalom relevantnom dokumentacijom na imejl adresu: burimetnjerezore@pallatirinise.com Obrazac za prijavu i izjava pod zakletvom mogu se preuzeti sa veb stranice N.P.L. PALATI I RINISE AD sa sedištem u Prištini na <http://www.pallatirinise.com/> ili se mogu dobiti u kancelarijama Kompanije.

6. Napomena:

Kandidati sa nepotpunom, nekompletnom i neadekvatnom dokumentacijom i van roka za konkurs biće odbijeni. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju navedene kriterijume i koji su uvršteni u uži izbor.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- “Lisi Group” SH.P.K. me numër Unik Identifikues: 810845167 bënë ulje të kapitalit nga 140,000.00 në 1000.
- Trim Rezniqui shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të sh.m.p “Gjon N. Kazazi” Gjakovë.
- Vjosa (Jusuf) Gradinaj, shpall të pavlefshme certifikatën e dhënies së Provimit të Jurisprudencës, me nr. 91/2017, të lëshuar në Prishtinë më 13.03.2017, për provimin e jurispru-dencës të dhënë më 31.01.2017, nga Ministria e Drejtësisë.
- Vjosa Jusuf Gradinaj shpall të pavlefshme diplomën LL.M. (Master) në Kontrata dhe të Drejtën Komerciale, në emër të, nr. 1689, të lëshuar më 27.02.2018, nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” – Fakulteti Juridik.
- “Master Build SRL Dega në Kosovë” shpall të pavlefshme certifikatën e biz-nesit me nr. Unik Identifikues: 811932583.
- Thot Ratkoceri shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme “28 Nëntori” shkolla Teknike Prishtinë.
- Driton Bucaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “ Abdyl Frasheri “ Prizren.
- Armend Hoxhaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q K “11 Marsi “ Prizren.
- Trim Rezniqui shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të sh.m.p “Gjon N. Kazazi” Gjakovë.
- Sokol Haxhikadrija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 33049408.
- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811149542 të lëshuar nga ARBK.
- Genti Kurhasku shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të sh.m. mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Sebastjan Prenka shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shf.f.m.u “Ahmet Rrustemi” Bec Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.
- Xhelal Halilosmani shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e sh.m. Ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.
- Diana Morina shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Albana Gjocaj nga Juniku shpall të pavlefshme diplomën e universiteti Publik “Fehmi Agani” Gjakovë, drejtimi Infermieri, Bachelor me nr. 104.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L